



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“TVR” SH.P.K
Nr. biznesit 70994054
Pronar – Rifat AVDIU
OSHP “TVR”
Rr/Ahmet KRASNIQI pn.
Lagjja Arbëria
Prishtinë

Ref: 1312/1734/KPM/ni

VENDIM

për licencimin e kandidatit për ofrues të shërbimeve programore OSHP “TVR” – Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për distribuimin kabllor të programeve radiotelevizive në Kosovë (CIMC 2007/04), ka hyrë në fuqi më 06.07.2007. Ndërsa, në bazë të Nenit 16 të Rregullores CIMC 2007/04, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Programore, të cilët do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore dhe të cilat programe do të transmetohen vetëm përmes operatorëve kabllorë.
3. Më 4 nëntor 2013, kandidati për Ofrues të Shërbimeve Programore OSHP “TVR” , ka paraqitur aplikacionin e kompletuar për Licencë të KPM-së dhe në pajtim me bazën ligjore të KPM-së.
4. Në bazë të udhëzimit të KPM-së për plotësim të kërkesës me dokumentacion përkatës, kandidati OSHP “TVR” me datën 27 maj 2014, ka dorëzuar dokumentet e kërkuara nga KPM duke vepruar në pajtim të plotë me udhëzimin e KPM-së të datës 15 maj 2014.

1/2

Arsyetim

5. Në bazë të nenit 16.4 të Rregullores 2007/04, Ofruesit e Shërbimeve Programore do të rregullohen sikurse subjekte transmetuese.
6. KPM vlerëson se kandidati për licencë të KPM-së “TVR”, në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhëna e nevojshme për Licencë të KPM-së, për të ofruar shërbime programore në pajtueshmëri me Nenin 16 të Rregullores CIMC 2007/04.
7. KPM vlerëson se kandidati për OSHP “TVR” ka ofruar informacione të mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Informacionet e ofruara mund të konsiderohen si informacione bindëse lidhur me skemën programore në përgjithësi, duke paraqitur një strukturë të qartë organizative, informacione rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve programore.
8. Në pajtim me nenin 16.4 të Rregullores 2007/04, Ofruesi i Shërbimeve Programore OSHP “TVR”, duhet të veprojnë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
9. KPM vlerëson se kandidati për ofrues të shërbimeve programore OSHP “TVR” ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së, në pajtim të plotë edhe me Rregulloren e KPM-së për Dhënien e Licencës (KPM-2013/04).

VENDIM

10. KPM merr vendim që kandidatin OSHP “TVR”, me seli në Prishtinë, t’i lëshojë licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Programore në Republikën e Kosovës.

Lëshimi i Vendimit

11. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur i Mediave dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.

Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



11.06.2014
datë